



Republika e Kosovës - Republika Kosova  
Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborna komisija za žalbe i molbe

**A nr. 25/2009**

Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia, në panelin e përbërë nga Osman Tmava, kryesues, Fahredin Ymeri dhe Muharrem Shala, anëtarë, përkitazi me ankesën e Shtabit Zgjedhor të Partisë Demokratike të Kosovës, dega në Shtërpcë, në seancën e mbajtur më datë 26.10.2009, mori

### **VENDIM**

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

### **ARSYETIMI**

Shtabi Zgjedhor i Partisë Demokratike të Kosovës - dega në Shtërpcë, ka parashtruar ankesë me të cilën pretendon se Drejtori i Departamentit të Shëndetësisë, Tefik Islami, njëherësh kandidat për Kryetar të Shtërpcës nga radhët e Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), punon dhe zhvillon fushatë brenda institucionit publik.

### **FAKTET**

Më 21 tetor 2009, Komisioni për Ankesa dhe Parashtrësia (KZAP) ka pranuar një ankesë nga Shtabi Zgjedhor i Partisë Demokratike të Kosovës - dega në Shtërpcë, ku deklarohet se Tefik Islami, drejtor aktual i Departamentit të Shëndetësisë dhe kandidat për kryetar komune nga LDD, ka shkelur Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP), siç parashihet në nenin 35.1, duke zhvilluar fushatë elektorale për veten dhe subjektin e vet politik. Gjithashtu, pretenduesi ofron si fakte incizimin e ngjarjes në TV Tema – Ferizaj. Për më tepër, ankuesi deklaroi se më 21 tetor 2009, ora 11 në Brod, ky kandidat për kryetar komune ka përruruar ambulancën dhe ka bërë fushatë zgjedhore për vete, në kundërshtim me rregullat zgjedhore.

### **ANALIZË**

Jurisdiksioni i KZAP-it lidhur me ankesat është caktuar në pajtim me kompetencat e dhëna nga Kuvendi i Republikës së Kosovës në *Ligjin mbi Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës – LZP* (Ligji nr 03/L- 073) dhe *Ligjin për Zgjedhjet Lokale në Republikën Kosovës* (Ligji nr 03 / L-072).

KZAP-i vlerëson se Ankesa është e parregullt për faktin se nuk përmban të gjitha elementet e domosdoshme të parashikuara me dispoziten 3.5 të Rregullave dhe Procedurave të KZAP-it, përkatësisht Ankesa nuk është nënshkruar nga pala.

Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Komisioni Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa në Prishtinë**

A nr. 25/2009 më datën 26.10.2009.

